



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština -Municipality of Prishtina

**Drejtoria Komunale e Arsimit**

Prishtinë

Nr. 03-352 , datë 29.06.2026

Bazuar në nenin 62 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të nenit 5, shkronja b) të Ligjit nr. 03/L068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 08/L – 153 për edukimin në fëmijërinë e hershme, në nenin 4 paragrafi 8 të Udhëzimit Administrativ (MASHTI) nr. 03/ 2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë, Drejtoria e Arsimit shpallë këtë:

**KONKURS**

**PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE PUBLIKE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS PËR VITIN 2026/2027**

<b>Vendet e lira në Institucionet parashkollore 2026-2027</b>										
<b>Grup- moshë</b>	<b>IP. Dielli</b>	<b>IP. Yllkat</b>	<b>IP. Fatosat</b>	<b>IP. Xixëllonjat</b>	<b>IP. Buzëqeshja</b>	<b>IP. Ardhmëria</b>	<b>IP. Lulevera</b>	<b>IP. Gëzimi Ynë</b>	<b>Cerdhja e re ne Dardani</b>	<b>Gjithsej</b>
1- > 2 vjeç	22	24	33	12	10	20	20	40	19	200
2- > 3 vjeç	0	0	0	0	0	0	4	6	0	10
3- > 4 vjeç	6	24	0	4	4	6	8	21	0	73
4- >5 vjeç	0	0	0	12	18	0	0	10	0	40
5- >6 vjeç	0	0	0	0	0	0	5	0	5	10
3-6 vjeç	0	0	0	0	0	0	0	6	0	6
<b>Gjithsej</b>	<b>28</b>	<b>48</b>	<b>33</b>	<b>28</b>	<b>32</b>	<b>26</b>	<b>37</b>	<b>83</b>	<b>24</b>	<b>339</b>

## **I. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:**

- Formulari i aplikimit (merret në institucionin përkatës parashkollor);
- Dokumenti personal i prindit (letërnjoftim ose pasaportë);
- Ekstraktin e lindjes së fëmijës;
- Vërtetim vendbanimi nga Drejtoria e Urbanizmit ose nga E-Kosova;
- Faturën e shërbimeve komunale (rryma, ujë, mbeturina, ngrohje apo internet), jo më e vjetër se 6 muaj, jo më e re se 30 ditë;
- Prindërit që janë duke banuar me qira në zonën përkatëse të çdo Institucioni Parashkollor të dorëzojnë dëshminë e kontratës së noterizuar (Jo më e re se gjashtë muaj) dhe dëshminë nga ATK që paguajnë tatimin mbi qiranë;
- Prindërit që janë duke banuar me qira dhe nuk kanë kontratë të noterizuar, sjellin dëshmi të pagesës të internetit apo ndonjë shërbimi tjetër (Jo më e re se gjashtë muaj);
- Dëshmia nga mjeku për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të fëmijës;
- Në rast se fëmija është me nevoja të veçanta, duhet të bashkëngjitet dëshmia e vlerësimit nga Ekipi Komunal i Vlerësimit ose raporti mjekësor/diagnoza e lëshuar nga QKUK apo Drejtoria e Mirëqenës Sociale Në Komunë të Prishtinës;
- Dëshmia për vaksinimin e fëmijës (vërtetimin për vaksinim nga QKMF dhe fletorën e shëndetit të fëmijës);
- Vërtetimi për marrëdhënien e punës për të dy prindërit (nëse prindërit janë në marrëdhënie pune);
- Pasqyrat e Trustit për të dy prindërit për gjashtë (6) mujorin e fundit;
- Prindërit të cilët janë të papunësuar duhet të sjellin dëshmi nga Enti për punësim.
- Dëshminë që ka fëmijë të tjerë të regjistruar në institucionin parashkollor përkatës (nëse ka);
- Dokumente të tjera origjinale ose të noterizuara për të dëshmuar kategorinë përkatëse të specifikuar në Vendimin e Drejtorisë së Arsimit nr. 03-353-2026 të dt. 29.06.2026

## **II. Kushtet dhe kriteret e regjistrimit të fëmijëve në institucionet parashkollore**

- Regjistrimi i fëmijëve në IP do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit në fëmijërinë e hershme (Ligjit nr. 08/L-153 për edukimin në fëmijërinë e hershme), në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr. 03/ 2022 për pranimin e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë dhe në Vendimin e kriterëve të pranimit të fëmijëve në institucionet parashkollore publike të Drejtorisë së Arsimit nr.03-353-2026 të datës 29.06.2026.

## **Afati dhe mënyra e aplikimit**

- Konkursi mbetet i hapur nga data e publikimit më 29.06.2026 deri më datën 13.07.2026;
- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në institucionin parashkollor përkatës çdo ditë punte prej orës 08:00 deri në ora 16:00;
- Palët e pakënaqura me rezultatet e regjistrimit mund të ushtrojnë ankesë në institucionin parashkollor përkatës në afat prej tetë (8) ditëve pas datës së publikimit të rezultateve;
- Palët e pakënaqura me përgjigjen e IP-së, mund të ushtrojnë ankesë në DKA, si shkallë e dytë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve; DKA nuk shqyrton asnjë ankesë, nëse e njëjta nuk është shqyrtuar me shkrim nga IP përkatëse.
- Të gjitha dokumentacionet e pakompletuara dhe jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

**Nr. 03-354-2026**

**Dt. 29.06.2026.**

**DREJTORIA E ARSIMIT**

Në bazë dispozitave të nenit 24.2 dhe 24.5 të Ligjit Nr. 08/L-153 Për edukimin në fëmijërinë e hershme, nenin 3 të UA Nr. 41/2007, dt. 9.10. 2007 Zbritja e tarifave që duhet të paguhen nga prindërit për më shumë se një fëmijë në institucionet parashkollore, nenin 4, paragrafi 5 të UA Nr. 03/2022 Për përfshirjen e fëmijëve në Institucione parashkollore në Kosovë, nenin 2, paragrafi 2.3 të Rregullores 01 nr. 110-157460, dt. 01.07.2014 Për të hyrat vetanake të Institucioneve Arsimore, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, drejtori i Drejtorisë për Arsim publikon këtë:

**NJOFTIM**

**I. Për lirim nga pagesa për fëmijët në Institucione Parashkollore për vitin edukativ 2026/2027.**

**Të drejtë lirimi nga pagesa kanë vetëm:**

- a) Fëmijët e invalidëve të luftës lirohen nga pagesa 100%
- b) Fëmijët bonjakë (pa të dy prindërit) 100%;
- c) Fëmijët me nevoja të veçanta 100%
- d) Fëmijët në asistencë sociale 100%
- ç) Fëmijët me njërin prind lirohen 100%;
- d) Fëmijët e veteranëve të luftës 100%;
- e) Prindërit që kanë më shumë se një fëmijë në IP të regjistruar, për një fëmijë do ta paguaj tarifën e plotë, për fëmijën e dytë lirohet 30%, për fëmijën e tretë lirohet 50% nga tarifa aktuale (kjo kategori mund të aplikoj vetëm në një Institucion Parashkollor).

**II. Të gjithë parashtruesit e kërkesave duhet ti paraqesin këto dokumente:**

- Kërkesën për lirim nga pagesa për vitin 2026/2027
- Certifikatën e lindjes së fëmijëve
- Kopjen kontratës me IP

***Invalidët e luftës duhet t'i paraqesin edhe:***

- Vendimin original (ose kopjen e vërtetuar të noteri) të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të pensionit për invalid të luftës;

***Prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta edhe:***

- Vërtetimin zyrtar për fëmijën me nevoja të veçanta (vërtetimi nga HANDIKOS apo nga Ministria e punës dhe Mirëqenies Sociale).

***Prindërit e fëmijëve në asistencë sociale edhe:***

- Vërtetimin zyrtar që dëshmon periudhën aktuale që janë në asistencë sociale nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

***Kujdestaret fëmijëve bonjakë (pa të dy prindërit) edhe:***

-Certifikatën e vdekjes se prindërve (origjinale)

***Prindi i vetëm pa bashkëshorte/bashkëshort edhe:***

-Certifikatën e vdekjes së bashkëshortit/ës (origjinale)

***Prindi vetushqyes edhe:***

-Dëshmi na Gjykata ose konstatimi (dokument zyrtar) nga Qendra për Punë Sociale se njëri nga prindërit është duke u kujdesur për fëmijët.

***Prindërit që kanë me shumë se një fëmijë të regjistruar ne çerdhet publike edhe:***

-Certifikatën e lindjes të secilit fëmijë (origjinale) dhe fletëregjistrimin e tyre në institucionet përkatëse.

**VËMENDJE:** Për të gjitha rastet e liruara nga pagesa prindërit/kujdestarët ligjor, duhet të dëshmojnë me dokument zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kërkesën e lirimit, në të kundërtën e njëjta do të refuzohet.

III. Lirimi nga pagesa, bëhet nga shtatori i vitit 2026 deri 31 gusht 2027.

Kërkesat dorëzohen në administratën e IP-së përkatëse.

Afati për paraqitjen e kërkesës është nga datë 29.06.2026 deri me datë 13.07.2026

U dorëzohet :

- Institucioneve parashkollore publike (IP);
- Drejtorisë së Arsimit



Arianit Elshani

DREJTOR I ARSIMIT



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

---

**DREJTORIA E ARSIMIT**

Nr. 03-353-2026;

Data: 29.06.2026

Bazuar në nenin 62 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L – 040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), nenin 57 shkronja e. të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, si dhe bazuar në ligjin nr. 08/L-153 dhe të gjitha ligjet që rregullojnë fushën e arsimit para universitar, në nenin 4 paragrafi 8 të Udhëzimit Administrativ (MASHTI) nr. 03/2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore në Kosovë, Drejtoria e Arsimit merr këtë:

**V E N D I M**

**PËR KRITERET E PRANIMIT TË FËMIJËVE NË INSTITUCIONET  
PARASHKOLLORE PUBLIKE**

- I. Vetëm fëmijët e prindërve që janë banorë të komunës së Prishtinës mund të regjistrohen në institucionet parashkollore publike (IP) të Komunës së Prishtinës;
- II. Në institucionet parashkollore publike mund të regjistrohen fëmijët prej moshës 9 muaj deri në 6 vjeç;
- III. Llogaritja e moshës së fëmijëve bëhet duke marrë parasysh datën e fillimit të shërbimit përkatësisht datën 31 Gusht;
- IV. DKA themelon komisionin për pranimin e fëmijëve në afat prej 5 ditësh pas shpalljes së konkursit.

---

Faqe 1 nga 4

V. Nëse Komisioni i pranimit të fëmijëve gjatë procesit të regjistrimit konstaton se ka dy e më shumë fëmijë me pikë të barabarta, atëherë duhet praktikuar shortin, i cili bëhet në prani të prindërve të fëmijëve dhe KDSH-së përkatëse. E njëjta procedurë kur fëmijët kanë pikë të barabarta vlen edhe për fëmijët që mbestin në listën pritëse (të papranuar), që sistemohen përgjatë vitit edukativ;

VI. Për prindërit të cilët kanë tashmë të regjistruar një fëmijë në institucionin përkatës parashkollor, kriteri i zoonimit të ri nuk zbatohet. Këta prindër konsiderohen se e plotësojnë kriterin e zoonimit dhe u njihen pikët përkatëse, sikur të kenë vendbanimin në zonën e përcaktuar për institucionin.

VII. Të gjithë prindërit këshillohen të shqyrtojnë me kujdes zonimin e institucionit parashkollor për të cilin aplikojnë, pasi Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) ka bërë ndryshime në zonimin e secilit institucion parashkollor, si rezultat i hapjes së institucioneve të reja parashkollore;

VIII. Pranimi i fëmijëve në IP bëhet në bazë të numrit më të madh të pikëve totale që merr një kandidat bazuar në kriteret e specifikuar në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Kategoritë	Pikët
1	Fëmijët bonjakë pa të dy prindërit	100
2	Fëmijët bonjakë (pa njërin prind), pa dallim nëse prindi kujdestar është i punësuar apo i papunësuar.	90
3	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse të dy prindërit punojnë	80
4	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse njëri prind punon	60
5	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse asnjëri prind nuk punon	40
6	Fëmijët e prindërve të divorcuar me vendim gjyqësor (të dëshmuar me dokumentacion përkatës), nëse prindi kujdestar është i punësuar	60
7	Fëmijët e prindërve të divorcuar me vendim gjyqësor, (të	35

	dëshmuar me dokumentacion përkatës), nëse prindi kujdestar është i papunësuar	
8	Fëmijët e prindërve në proces divorci (të dëshmuar me dokumentacion përkatës), nëse prindi kujdestar është i punësuar	35
9	Fëmijët e prindërve në proces divorci (të dëshmuar me dokumentacion përkatës), nëse prindi kujdestar është i papunësuar	20
10	Prindërit e fëmijëve në asistencë sociale	50
11	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	40
12	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse njëri prind punon	30
13	Fëmijët e invalidëve të luftës së UÇK-së nëse asnjëri prind nuk punon	20
14	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	20
15	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse njëri prind punon	25
16	Fëmijët e veteranëve të luftës së UÇK-së nëse asnjëri prind nuk punon	10
17	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura bruto mujore të prindërve deri në 1000€)	45
18	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura bruto mujore të prindërve 1001-1400€)	35
19	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura bruto mujore të prindërve 1401- 1900€)	30
20	Fëmijët që punojnë të dy prindërit (me të ardhura bruto mujore të prindërve mbi 1901€)	15
21	Fëmijët e punëtorëve të IP-ve	10

22	Fëmijët e prindërve që janë banorë të lagjes brenda Zonimit të Institucionit Parashkollorë	35
23	Fëmijët e prindërve që tashmë kanë një fëmijë vijues në IP	15
24	Nëse prindërit aplikojnë për dy a më shumë fëmijë, njeri nga fëmijët pranohet automatikisht i shtohen këto pikë.	10
25	Fëmijët që njëri prind ju punon (me të ardhura bruto mujore të prindit deri në 800€)	25
26	Fëmijët që njëri prind ju punon (me të ardhura bruto mujore të prindit deri në 801-1200€)	15
27	Fëmijët që njëri prind ju punon (me të ardhura bruto mujore të prindit mbi 1201€)	10

**Vërjetje:**

*Çdo aplikant mban përgjegjësi të plotë për vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur. Në rast të konstatimit të falsifikimit apo paraqitjes së të dhënave të pasakta, aplikimi refuzohet dhe ndërmerren masa në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

IX. Të gjitha statuset e të gjitha kategorive të përfshira në tabelën e mësipërme duhet të dëshmohen me dokumente valide të lëshuara nga institucionet relevante;

X. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi 03 nr.199-25, dt.05.06.2025, për kriteret e pranimi të fëmijëve në institucionet parashkollore publike;

XI. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

**U dorëzohet:**

- Institucioneve parashkollore publike (IP);
- Drejtorisë së Arsimit.

